



Agjencia e Mbikëqyrjes Policore

KORRIK 2023

Agjencia ka marrë masa dhe ka siguruar kushtet për të zbardhur dhe administruar ankesat e ardhura në mënyrë të drejtëpërdrejtë nga publiku, si dhe ankesa e shqetësime të adresuara nëpërmjet institucioneve të tjera të administratës publike apo nga media vizive dhe ajo e shkruar.

Të gjitha ankesat e reja regjistrohen në Sistemin e Menaxhimit të Çështjes, për t'u ndjekur në vijim, në kohë reale, në përputhje me ligjin dhe procedurat standarde të punës për trajtimin e ankesave.

MËNYRAT E KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT

Për ankesa ndaj strukturave objekt i veprimtarisë



ankesa@amp.gov.al



0800 90 90

Për denoncime në kuadër të Vetingut në Polici



denonco@amp.gov.al



Rr. "Asim Vokshi", Nr. 19/1, Tiranë

Për t'u paraqitur në zyrat tona



Zyra e Pritjes së Qytetarëve në Drejtorinë e Përgjithshme

Zyrat e Drejtorive Rajonale pranë DVP-ve në Qarqe

Për t'u informuar rreth AMP, na ndiqni



www.amp.gov.al



VEPRIME HETIMORE

Referimet e bëra në Prokurori

21 referime në Prokurori për **25** punonjës të Policisë së Shtetit dhe **3** punonjës të Gardës së Republikës, si të dyshuar për vepra të ndryshme penale.

Arrestuar/ndaluar në flagrancë

2 punonjës policie dhe **1** punonjës i Gardës së Republikës të arrestuar në flagrancë

Ekzekutimet e vendimeve të dhëna nga Prokuroria/Gjykata

Vendosur caktimi i masës "Pezullim i ushtrimit të një detyre nga shërbimi publik": 3 punonjës policie

INSPEKTIVE/VENDIME

Gjatë muajit Korrik janë kryer **6 inspektive** të paplanifikuara dhe në 2 raste është rekomanduar fillimi i hetimit disiplinor për 10 punonjës policie, prej të cilëve 6 punonjës për "Shkelje të rëndë" dhe 4 punonjës për "Shkelje të lehtë".

Komisioni Disiplinor ka shqyrtuar për muajin Korrik në total **12 praktika disiplinore**, nga të cilat në 11 praktika ka konstatuar dhe vendosur fillimin e hetimit disiplinor për 22 punonjës policie, ndërsa në 1 praktikë ka vendosur rekomandimin për fillimin e hetimit disiplinor për "Shkelje të lehtë" ndaj 1 punonjësi policie, si më poshtë:

- Për 1 punonjës policie, Komisioni Disiplinor ka vendosur dhënien e masës disiplinore "Shtyrje të afatit të gradimit për 2 vite".
- Për 3 punonjës policie, Komisioni Disiplinor ka vendosur dhënien e masës disiplinore "Shtyrje të afatit të gradimit për 1 vit".
- Për 6 punonjës policie, Komisioni Disiplinor ka vendosur dhënien e masës disiplinore "Shtyrje të afatit të gradimit për 6 muaj".
- Për 7 punonjës policie, Komisioni Disiplinor ka vendosur përfundimin e hetimit disiplinor pasi nuk janë konstatuar shkelje administrative.
- Për 5 punonjës policie, Komisioni Disiplinor ka vendosur fillimin e hetimit disiplinor për "Shkelje të rëndë".
- Për 1 punonjës policie Komisioni Disiplinor ka vendosur rekomandimin për fillimin e hetimit për "Shkelje të lehtë" dërguar Drejtorisë së Standardeve Profesionale në DPPSH.

HETIME ADMINISTRATIVE TË ANKESAVE

Zyra e pritjes së qytetarëve dhe komunikimi me publikun



424 Telefonata

në linjën e gjelbër **08009090**, nga të cilat;ilat:

185 telefonata brenda objektit të veprimtarisë së AMP (Në ndjekje nga strukturat përgjegjëse të Agjencisë)

118 telefonata jashtë objektit të veprimtarisë së AMP (Adresuar strukturave të administratës publike për ndjekje)

121 telefonata i është dhënë informacioni sipas rastit (Qytetarët janë orientuar drejt strukturës kompetente të administratës publike që trajton ankesat e tyre)



Ankesa të trajtuara

135 ankesa

- Në **22** raste, ankesat e qytetarëve kanë qenë të drejta
- Në **77** raste, ankesat e qytetarëve kanë qenë të pabazuara
- Në **36** raste, ankesat e qytetarëve nuk provohen



Ankesa të administruara

Administrimi nënkupton regjistrimin e çdo ankese, pavarësisht nëse duhet të ndiqet nga Agjencia apo një institucion tjetër i Administratës Publike. Ankesat administrohen në Sistemin e Menaxhimit të Ankesave, ku secila merr një numër unik.

134 ankesa